



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 13.2.2023

- Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 287/2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të seancës gjyqësore publike të datës 31.1.2023, që i përket ankimit të Komisionerit Publik, kundër vendimit nr. 287, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, u vendos të çelet hetimi gjyqësor i çështjes dhe të pranohen në cilësinë e provës aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur parashtrimeve.

Aktet e lejuara nga trupi gjykues për t’u marrë në cilësinë e provës u inventarizuan në seancë dhe u konfirmua marrja e tyre nga Komisioneri Publik. Për sa i takon shkaqeve të ankimit, referuar edhe parashtrimeve me shkrim dhe akteve të administruara gjatë këtij gjykimi, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe profesionalizmit, edhe pas shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, mbeti e provuar se:

A. Për shkakun ankimor për vlerësimin e pasurisë:

1. *Lidhur me pasurinë, apartament banimi, me sipërfaqe totale 104.33 m² ndodhur në Tiranë, në vlerën 75.000 euro, mbi burimin e deklaruar, kursime familjare në shumën 5.000 euro*

1.1 Për këtë shkak ankimi, referuar parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 31.1.2023, duke iu qëndruar parashtrimeve të paraqitura nga ky institucion në datë 31.1.2023, Komisioneri Publik vlerëson se pretendimet e subjektit lidhur me ndryshimet e likuiditeteve *cash* mbeten në nivel deklarativ dhe janë në kundërshtim me jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit.

1.2 Në vijim vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklarime të pasakta në DV-2006 dhe kontradiktore mbi shlyerjen e pagesës 5.000 euro; (ii) nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pagesën e kësaj shume deri në datën **.3.2006. Edhe nga analiza vjetore e vitit 2006, duke rivlerësuar zërin “likuiditete *cash*”, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të ardhurash të ligjshme për të investuar në pasurinë *apartment 104 m²*, për të kursyer shumën 500.000 lekë, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, në vlerën negative - 1.066.211 lekë.

2. Lidhur me analizën financiare për vitet 2005, 2007, 2009-2014

2.1 Për këtë shkak ankimi, referuar parashtrimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore të datës 31.1.2023, duke iu qëndruar parashtrimeve të paraqitura nga ky institucion në datën 31.1.2023, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me: (i) të ardhurat e pretenduara si ndihmë financiare nga babai i personit të lidhur, pasi shumat e pretenduara nga subjekti nuk janë deklaruar si të ardhura apo dhurime, në deklaratat periodike vjetore dhe atë “Vetting”; (ii) likuiditetet *cash*, për sa arsyetuar më lart në pikën 1.1, si dhe (iii) shpenzimet e jetesës të familjes së subjektit të rivlerësimit, për sa kohë këto shpenzime janë shpenzime minimale jetese.

2.2 Në përfundim, sikurse është arsyetuar në ankim dhe në parashtrimet e Komisionerit Publik të datës 31.1.2023, rezulton se, nga rivlerësimi i këtyre zërave në analizën financiare, të kryer nga Komisioni për periudhën 2005-2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë më të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për vitet 2005, 2007 dhe 2009-2014, për një diferencë totale në vlerën negative - 3.256.276 lekë.

3. Lidhur me pasurinë automjet tip “Audi A4”, me targa: ***

3.1 Për këtë shkak ankimi, referuar parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 31.1.2023 dhe akteve të depozituara, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe nëse marrim në konsideratë mundësinë huadhënëse të shtetasit ***.***, për t’i dhënë hua personit të lidhur shumën 6.000 euro, përsëri rezulton se, nga rishikimi i zërave: (i) “ndihmë financiare nga vjehri”, (ii) “shpenzime jetese” dhe (iii) “ndryshim në likuiditete”, në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të ardhurash të ligjshme për të investuar në pasurinë automjet “Audi A4”, për të shlyer huan, si dhe për të mbuluar kursimet dhe shpenzimet e tjera familjare, për një diferencë në vlerën negative - 1.007.151 lekë.

4. Në përfundim, për vlerësimin e kriterit të pasurisë, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar investimet, shpenzimet dhe kursimet gjatë periudhës 2005 - 2016, për një diferencë totale në vlerën negative prej - 5.329.638 lekë.

5. Referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3, si dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë.

B. Për shkakun ankimor lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale dhe atë tërësor

6. Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, parashtrimin të paraqitur dhe qëndrimeve të mbajtura në seancën gjyqësore të zhvilluar në Kolegj, në kuadër të këtij gjykimi, vlerëson se mangësitë e konstatuara në katër vendimet penale dhe një vendim civil, janë të bazuara dhe nuk u arrit të vërtetohet e kundërta nga parashtrimet me shkrim dhe ato verbale, si dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancë gjyqësore.

7. Konkretisht, tri vendimet penale, me burim vlerësimi: *Raportet e hartuara nga organet ndihmëse të procesit të rivlerësimit¹, përkatësisht KLGJ dhe Ministria e Drejtësisë, në të cilat subjekti i rivlerësimit ishte në cilësinë e gjyqtarit të vetëm: (i) Vendim penal nr. ***, datë **.3.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; (ii) Vendim penal nr.***, datë **.11.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, (iii) Vendim penal nr.***, datë **.5.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, gjetjet dhe vlerësimet e organeve ndihmëse janë të bazuara dhe duhen marrë në shqyrtim, dhe vlerësuar në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi afektojnë nënindikatorët e parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016, si dhe në këndvështrim të vlerësimit tërësor, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*

8. Për dy vendimet e tjera, njëri objekt kontrolli, bazuar në denoncimin e publikut, dhe tjetri si çështje e diskutuar dhe e bërë publike për zbatimin e nenit 64 të Kodit Penal, vlerësojmë se:

8.1 Vendimi nr.***, datë **.12.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku subjekti është në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, referuar shkakut ankimor dhe duke iu qëndruar parashtrimeve të paraqitura nga ky institucion në datën 31.1.2023, edhe pas paraqitjes së prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, në formë të shkruar dhe verbalisht në seancë gjyqësore, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit, në gjykimin me objekt: “*rivendosje në afat*”, ka shkelur një dispozitë urdhëruese, si ajo që përmban neni 152 i Kodit të Procedurës Civile, duke mos realizuar thirrjen e njëjës prej palëve pjesëmarrëse në gjykim. Si e tillë, vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit duhet marrë në shqyrtim dhe vlerësuar në panoramën e përgjithshme të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në këndvështrim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi afektojnë nënindikatorët e parashikuar nga neni 72, pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 96/2016.

¹ Raporti i vlerësimit profesional, i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Raporti i inspektimit, i Ministrisë së Drejtësisë.

9. Vendimi penal nr. ***, datë **.12.2016, i Gjykatës së Apelit Durrës, në të cilin subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, është gjetur në zbatim të gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material, nga vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Referuar shkakut ankimor dhe duke iu qëndruar parashtrimeve të paraqitura nga ky institucion në datën 31.1.2023, edhe pas paraqitjes së prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, në formë të shkruar dhe verbalisht në seancë gjyqësore, Komisioneri Publik çmon se vendimmarrja, pjesë e së cilës është subjekti i rivlerësimit, duhet marrë në shqyrtim dhe vlerësuar në panoramën e përgjithshme të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në këndvështrim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi afektojnë nënindiktorët e parashikuar nga neni 72, pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 96/2016.

C. Kërkimi përfundimtar

Duke përfunduar për sa parashtruar, Komisioneri Publik, bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-34, 40-44, nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016; dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, kërkohet nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 287, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, zonjës Anita Mici.*

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA